



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Ministarstvo Ekonomskog Razvoja - Ministry of Economic Development

**BALANCA AFATGJATE E ENERGIJISË E
REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2015-2024**

**DUGORU NI ENERGETSKI BILANS
REPUBLIKE KOSOVO 2015-2024**

**LONG TERM ENERGY BALANCE OF
THE REPUBLIC OF KOSOVO 2015-2024**

Prishtinë, Dhjetor 2014



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Ministarstvo Ekonomskog Razvoja - Ministry of Economic Development

**BALANCA AFATGJATE E ENERGJISË
E REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2015 - 2024**

Dhjetor, 2014

Përmbajta

1. Metodologjia e parashikimit të kërkesës për energji dhe mbulimit të saj.....	5
2. Parashikimi i kërkesës për energji në sektorin e amvisërisë.....	6
3. Parashikimi i kërkesës për energji në sektorin e shërbimeve.....	7
4. Parashikimi i kërkesës për energji në sektorin e industrisë.....	8
5. Parashikimi i kërkesës për energji në sektorin e transportit.....	9
6. Parashikimi i kërkesës për energji në energji në sektorin e bujqësisë.....	10
7. Parashikimi i kërkesës për energji për të gjithë sektorët.....	10
8. Parashikimi i kërkesës për burime të ndryshme të energjisë.....	12
9. Parashikimi i konsumit të energjisë elektrike për periudhën 2015-2024.....	13
10. Parashikimi i prodhimit të energjisë elektrike për periudhën 2015-2024.....	14
11. Parashikimi i importit të energjisë elektrike 2015-2024.....	15
12. Emetimi i ndotësve të ajrit nga prodhimi i energjisë elektrike në Kosovë.....	15
12.1. Gjendja aktuale e nivelit të emetimit të ndotësve nga termocentralet dhe parashikimi i emetimit 2015-2024.....	15

Shkurtesat e përdorura

MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
KOSTT sh.a	Operatori i Sistemit dhe Tregut
KEK sh.a	Korporata Energjetike e Kosovës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ZRrE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë
MF	Ministria e Financave
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
APK	Agjensioni Pyjor i Kosovës
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë
DK	Doganat e Kosovës
SKE	Sekretariati i Komunitetit të Energjisë
REKOS	Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë 2011
CRES	Qendra për burime të ripërtritshme dhe kursimin e energjisë, Athinë-Greqi
EUROSTAT	Enti i Statistikave i Komunitetit Evropian
IEA	Agjencioni Ndërkombëtar i Energjisë
GLN	Gazi i Lëngëzuar i Naftës
TC	Termocentral
HC	Hydrocentral
GWh	Giga Vat Orë
GW	Giga Vat
MWh	Mega Vat Orë
MW	Mega Vat
BRE	Burime të Ripërtritshme të Energjisë
BPV	Bruto Produkti Vendor

Ky dokument është përgatitur nga Divizioni i Politikave të Energjisë në MZHE, me mbështetjen dhe bashkëpunimin e ngushtë me entitetet e përcaktuara në Udhëzimin Administrativ nr.07/20111 Mbi Rregullat për Balancën e Energjisë.

1. Metodologjia e parashikimit të kërkesës për energji dhe mbulimit të saj

Dokumenti: "Balanca afatgjatë e energjisë e Republikës së Kosovës 2015-2024" është hartuar mbi bazën e disa dokumenteve dhe të dhënave plotësuese të grumbulluara nga ana e Divizionit për Politika të Energjisë në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

Dokumentet bazë, që kanë shërbyer si inpute të dokumentit: Balanca afatgjatë e energjisë e Republikës së Kosovës 2015-2024 si dhe burimi i tyre janë dhënë në vijim:

1. Të dhënat demografike-ASK-ja;
2. Të dhënat makroekonomike-MF-ja;
3. Të dhënat për parashikimin e kërkesave për energji elektrike dhe parashikimin e furnizimit me energji elektrike nga dokumenti: Balanca Afatgjatë e Energjisë Elektrike 2015-2024 nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT).
4. Të dhënat për prodhimin e thëngjillit nga dokumenti: Balanca Afatgjatë e Energjisë Elektrike 2015-2024 nga KOSTT.
5. Të dhënat për konsumin e energjisë elektrike nga dokumenti: Balanca Afatgjatë e Energjisë Elektrike 2015-2024, kurse për pjesëmarrjen e sektorëve të ekonomisë të dhënat janë marrë nga anketat e realizuara në vitin 2009, 2010, 2011, 2012 dhe 2013
6. Të dhënat për parashikimin e konsumit të ngrohjes janë marrë nga të dhënat e parashikuara nga ngrohtorja TERMOKOS- Prishtinë dhe ngrohtorja e qytetit të Gjakovës;
7. Të dhënat historike të konsumit të energjisë dhe sasisë bruto në dispozicion të energjisë si:
 - Balancat e realizuara të Energjisë të Republikës së Kosovës për vitet 2011, 2012 dhe 2013;
 - Parashikimi i kërkesave për Energji në Kosovë për vitin 2014 (të dhënat e vitit 2014 bazohen mbi bazën e rritjes së zhvillimit ekonomik të Kosovës për vitin 2014 krahasuar me vitin 2013) ;

Balanca afatgjatë e Energjisë për periudhën 2015-2024 bazohet në të dhëna të dokumenteve të realizuara të balancave të energjisë të cilat, sa i përket konsumit, janë të bazuara në anketa të specializuara të konsumit të sektorëve.

Të dhënat për energjinë elektrike janë marrë të gatshme nga të dhënat e Balancës Afatgjatë të Energjisë Elektrike për periudhën 2015-2024, të hartuar nga Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës, për arsye se ky është operator përgjegjës, sipas Ligjit Nr.03/L-184 për Energji, për hartimin e dokumenteve të balancave vjetore dhe afatgjatë të energjisë elektrike. Të dhënat për ngrohjen janë marrë nga dokumenti i parashikimit të ngrohjes, të përgatitur nga ngrohtorja TERMOKOS - Prishtinë dhe ngrohtorja e qytetit të Gjakovës.

Po ashtu, në këtë dokument janë analizuar edhe ndikimet e zhvillimeve makroekonomike në konsumin e energjisë. Ndërsa, të dhënat e grumbulluara janë përpunuar në bazë të kërkesave të formatit EUROSTAT.

Në llogaritjen e parashikimit të konsumit të energjisë, janë marrë parasysh tre faktorë bazikë:

1. rritja ekonomike;
2. numri i amvisërive dhe
3. konsumi i tri viteve të fundit.

Në tabelën në vijim paraqiten të dhënat e BPV- së të realizuar për periudhën 2009-2013.

	2009	2010	2011	2012	2013
BPV	3.6%	3.3%	4.4%	2.8%	3.4%

Burimi i të dhënave ASK.

2. Parashikimi i kërkesës për energji në sektorin e amvisërisë

Bazë për analizimin dhe llogaritjen e parashikimeve të kërkesave për energji, në sektorin e amvisërisë, janë të dhënat demografike, të cilat janë marr nga publikimi: “Parashikimi i popullsisë së Kosovës 2011-2061” të publikuar nga Agjencia për Statistikat e Kosovës.

Nisur nga të dhënat e regjistrimit të popullsisë, numri total i ekonomive familjare në Kosovë në vitin 2013 ka qenë 308,582, kurse numri mesatar i anëtarëve për amvisëri është 5.9. Kërkesat për energji, në sektorin e amvisërisë, janë më shumë në varshmëri me numrin e ekonomive familjare (një ekonomi familjare mund të ketë më shumë se një familje) se sa me numrin e popullsisë. Prandaj vlerësimi më i drejt i numrit të familjeve paraqet interes themelor në parashikimet e konsumit të energjisë në sektorin e amvisërisë.

Tabela 2. Parashikimi i rritjes së numrit të popullsisë, banorëve në familje dhe ekonomike familjare

	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025
Popullsia	1,827,231	1,836,978	1,847,632	1,857,867	1,867,495	186,250	1,883,805	1,892,993	1,901,106	1,907,940	1,913,467
Nr. i amvisërive	309,700	311,352	313,158	314,893	316,525	31,568	319,289	320,846	322,221	323,380	324,316

Burimi: ASK, DPE (MZHE)

Përveç të dhënave demografike që janë thelbësore për parashikimin e konsumit të energjisë, në sektorin banesor (amvisërisë), të dhëna tjera, po ashtu me rëndësi, që kanë shërbyer në procesimin e të dhënave për hartimin e këtij dokumenti, janë të dhënat nga dokumentet:

- Balanca Afatgjatë e Energjisë Elektrike 2015-2024 të hartuar nga Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT);
- Të dhënat historike nga dokumentet e balancave të energjisë për vitet 2012, 2013, të hartuara nga MZHE dhe parashikimi i vitit 2014;
- Të dhënat për prodhimin e ngrohjes për periudhën 2015-2024 nga të dhënat e parashikimit nga ngrohësorja TERMOKOS - Prishtinë dhe ngrohësorja e qytetit të Gjakovës;
- Të dhënat për importin dhe eksportin e thëngjillit dhe derivateve të naftës, bazohen mbi bazën e rritjes së zhvillimit ekonomik për vitin 2014 në krahasim me vitin 2013.

Tabela 3 . Parashikimi i konsumit të llojeve të ndryshëm të produkteve energjetike në sektorin banesor/amvisëri (në ktoe)

	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Thëngjill	18.46	18.64	18.83	19.02	19.21	19.40	19.59	19.79	19.99	20.19
Produkte naftë	17.61	18.19	18.79	19.41	20.05	20.71	21.39	22.10	22.83	23.58
Biomasa	233.93	236.50	239.10	241.73	244.39	247.08	249.80	252.55	255.33	258.13
Energji elektrike	256.84	248.88	252.61	259.43	264.10	270.18	277.47	284.41	294.08	304.66
Energji solare	0.21	0.31	0.36	0.41	0.49	0.54	0.59	0.64	0.70	0.80
Ngrohje e përfituruar	5.98	6.31	6.62	6.93	7.16	7.49	7.87	8.26	8.68	9.09
Totali	533.03	528.83	536.31	546.93	555.40	565.40	576.72	587.74	601.59	616.46

Nga Tabela 3 vërehet se kërkesa e përgjithshme për energji, në sektorin e amvisërisë, gradualisht do të rritet me një mesatare prej 1.8%, nga 533.03 ktoe në vitin 2015 në 616.46 ktoe në vitin 2024.

Produkti kryesor i konsumuar në sektorin e amvisërisë është energjia elektrike e cila në vitin 2016 parashihet të ketë ulje nga viti 2015 për -3.1%, kurse viteve të tjera do të ketë rritje dhe në vitin e fundit të parashikimit 2024 konsumi i energjisë elektrike do të jetë 304.66 ktoe.

Konsumi i biomases në sektorin e amvisërisë për periudhen 10 vjeqare do të ketë rritje të vazhdueshme. Rritja e biomases së konsumuar në vitin 2024 në krahasim me vitin 2015 do të ketë një rritje prej 10.35%.

Produktet e naftës në vitin 2015 parashihen të konsumohen 17.61 ktoe, kurse në vitin 2024 parashihen të konsumohen 23.58 ktoe.

Parashikohet rritje e kërkesave për thëngjill në masën rreth 1% në vit, kurse në vitin 2024 parashihet të arrijë në 20.19 ktoe i cili do të zëvendësoj një pjesë të sasisë së energjisë elektrike që aktualisht po përdoret për ngrohje.

Energjia solare dhe ngrohja e përfituruar janë parashikuar që të ken rritje gjate 10 viteve të ardhshme.

3. Parashikimi i kërkesës për energji në sektorin e shërbimeve

Parashikimi i kërkesës për energji edhe për këtë sektor bazohet në tendencat e përgjithshme të periudhës paraprake trevjeçare të bazuara në të dhënat e balancave të energjisë për tri vitet e fundit. Të dhënat për parashikimin e kërkesave për energji elektrike janë marrë nga Balanca Afatgjatë e Energjisë Elektrike 2015-2024 e përgatitur nga KOSTT ndërsa të dhënat për konsumin e ngrohjes qendrore janë marrë nga të dhënat zyrtare nga parashikimet e ngrohtoreve Termokos –Prishtinë dhe nga ngrohtorja e qytetit të Gjakovës.

Sikurse në sektorin e amvisërisë, edhe në sektorin e shërbimeve shpërndarja e konsumit të produkteve të energjisë është bërë në bazë të rezultateve të anketave me konsumatorë. Gjatë periudhës 2015-2024 parashihet një rritje e konsumit të energjisë kryesisht si rezultat i rritjes së kualitetit të shërbimeve të ngrohjes, klimatizimit dhe kushteve tjera në objektet e sektorit të shërbimeve ku bëjnë pjesë: ndërtesat qeveritare qendrore dhe lokale, objektet kulturore, arsimore, sportive, shëndetësore, hoteliere etj, duke përfshirë sektorin publik dhe atë privat.

Pritet të ketë një rritje stabile e konsumit të energjisë solare, sidomos në objektet publike (shkolla, spitale, etj) por edhe e ngrohjes së përqendruar.

Rritja mesatare e konsumit të energjisë në sektorin e shërbimeve do të jetë rreth 2% ku në vitin 2024 parashihet që konsumi total të jetë 163.17 ktoe.

Në vijim paraqitet tabela e parashikimit të konsumit për të gjitha produktet energjetike:

Tabela 4. Pasqyra e parashikimit të konsumit të llojeve të ndryshme të produkteve energjetike në sektorin e shërbimeve (në ktoe)

	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Thëngjill	6.72	6.79	6.86	6.93	7.00	7.07	7.14	7.21	7.28	7.35
Produkte naftë	42.46	43.31	44.18	45.06	45.96	46.88	47.82	48.77	49.75	50.74
Biomasa	7.16	7.23	7.30	7.38	7.45	7.52	7.60	7.68	7.75	7.83
Energji elektrike	70.77	70.06	72.16	74.33	76.55	78.85	81.22	83.65	87.00	90.48
Energji solare	0.50	0.72	0.84	0.96	1.14	1.26	1.38	1.50	1.63	1.87
Ngrrohje e përfituar	3.22	3.40	3.57	3.73	3.85	4.04	4.24	4.45	4.67	4.90
Totali	130.83	131.51	134.91	138.38	141.96	145.62	149.39	153.26	158.08	163.17

4. Parashikimi i kërkesës për energji në sektorin e industrisë

Të dhënat për konsumin e energjisë elektrike në sektorin industrial janë nxjerrë nga dokumentet e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT) dhe atë si një tërësi e kërkesës për energji elektrike.

Në sektorin e industrisë kohëve të fundit është vërejtur një rritje e moderuar e kërkesave për thëngjill sidomos pas fillimit të përdorimit të tij nga industria metalike, por edhe nga ajo ushqimore. Megjithatë, në sektorin e industrisë përsëri do të dominojë konsumi i produkteve të naftës, duke u përcjellë nga energjia elektrike. Një parashikim më i përafërt respektivisht, me konsolidimin e sistemit elektroenergjetik pritët edhe rritja e konsumit të energjisë elektrike si rezultat i dy elementeve:

1. Ndërtimit të termocentralit Kosova e re – me ç ‘rast do të kemi një besueshmëri të furnizimit me energji elektrike, dhe
2. Ndërprerja e përdorimit të agregateve – ndërprerjet e energjisë do të jenë shumë më të vogla se viteve të kaluara.

Deri në vitin 2024 pritet që sasia e energjisë elektrike e konsumuar nga sektori i industrisë të përbëjë 33% e energjisë në dispozicion në këtë sektor . Kjo pritet të ndodhë sepse projeksionet afatgjata zhvillimore janë të tilla që parashohin që Kosova të kaloj nga një shtet në fazë të hershme të zhvillimit, në një shtet me një zhvillimin të qëndrueshëm.

Tabela5. Pasqyra e parashikimit të kërkesave për produkteve të ndryshme energjetike në sektorin e industrisë (në ktoe)

	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Thëngjill për qëll. energjetike	34.75	35.09	35.45	35.80	36.16	36.52	36.88	37.25	37.63	38.00
Thëngjill qëll. jo-energjetike	0.48	0.48	0.49	0.49	0.50	0.50	0.51	0.51	0.52	0.52
Produkte naftë për qëll. energjetike	149.79	154.74	159.84	165.12	170.57	176.19	182.01	188.02	194.22	200.63
Produkte naftë për qëll.jo- energjetike	49.77	51.41	53.10	54.86	56.67	58.54	60.47	62.46	64.53	66.66
Biomasë	14.09	14.23	14.37	14.51	14.66	14.81	14.95	15.10	15.25	15.41
Energji elektrike	121.70	122.92	126.60	130.40	134.31	138.34	142.49	146.77	152.64	158.75
Totali	370.57	378.87	389.85	401.18	412.86	424.90	437.32	450.12	464.78	479.96

5. Parashikimi i kërkesës për energji në sektorin e transportit

Sektori i transportit tradicionalisht në Kosovë karakterizohet me produkte të naftës.

Siç vërehet edhe në Tabelën 6, konsumi në sektorin e transportit nafta dhe derivate e saj pritet të ken rritje lineare.

Vlen të përmendet se në parashikimin e konsumit të energjisë në sektorin e transportit, edhe pse ekziston teknologjia për te, nuk është marrë parasysh fare mundësia e shfrytëzimit të energjisë elektrike në sektorin e transportit.

Tabela 6. Pasqyra e parashikimit të konsumit të llojeve të ndryshme të energjisë në sektorin e transportit (në ktoe)

	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Dizel	255.16	262.82	270.70	278.82	287.19	295.80	304.68	313.82	323.23	332.93
Benzinë	57.99	57.41	56.83	56.26	55.70	55.14	54.59	54.05	53.51	52.97
Kerozinë	16.10	16.59	17.08	17.60	18.12	18.67	19.23	19.80	20.40	21.01
GLN	11.19	11.41	11.64	11.88	12.11	12.36	12.60	12.85	13.11	13.37
Totali	340.44	348.23	356.26	364.56	373.13	381.97	391.10	400.53	410.25	420.29

6. Parashikimi i kërkesës për energji në sektorin e bujqësisë

Në sektorin e bujqësisë, nafta dhe derivatet e saj janë burimi kryesor i konsumit të energjisë. Rritja mesatare e konsumit të energjisë në sektorin e bujqësisë deri në vitin 2024 do të jetë rreth 4.2%.

Duke ditur se sektori i bujqësisë pritet të jetë edhe njëri nga sektorët në të cilin do të investohet më shumë nga Qeveria e Kosovës, pritet një rritje e konsumit të energjisë elektrike (e cila do të mund të përdoret kryesisht gjatë procesit të përpunimit të produkteve bujqësore) dhe derivateve të naftës.

Në Tabelën 7, janë paraqitur parashikimet e konsumit të energjisë nga burime të ndryshme të saj.

Tabela 7. Pasqyra e parashikimit të konsumit të llojeve të energjisë në sektorin e bujqësisë (në ktoe)

	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Thëngjill	0.66	0.67	0.68	0.68	0.69	0.70	0.70	0.71	0.72	0.72
Produkte naftë	28.54	29.77	31.05	32.38	33.78	35.23	36.74	38.324	39.97	41.69
Biomasa	0.56	0.56	0.57	0.57	0.58	0.58	0.59	0.60	0.60	0.61
Energji elektrike	1.4	1.42	1.46	1.51	1.55	1.60	1.65	1.69	1.76	1.83
Total	31.19	32.42	33.75	35.14	36.59	38.11	39.68	41.32	43.05	44.86

7. Parashikimi i kërkesës për energji për gjithë sektorët

Nëse analizohet konsumi i energjisë në balancat paraprake të energjisë për të gjithë sektorët, shihet se deri në vitin 2013 konsumuesi më i madh i energjisë në Kosovë ka qenë sektori i amvisërisë, duke u përcjellë nga sektori i transportit dhe ai i industrisë.

Konsumit final i energjisë në vitin 2024 pritet të jetë 1724.73 ktoe. Ndikimet që do të kenë masat për rehabilitimin e sistemit elektroenergjetik dhe ndërtimi i termocentralit "Kosova e Re" pritet të kenë efektet e tyre sa i përket zvogëlimit të humbjeve teknike përkatësisht përmirësimit të efikasitetit të sistemit, që rritë sasinë e energjisë elektrike për konsum final nga kapaciteti i njejt, në njërin anë dhe stabilizimit të plotë të furnizimit të qëndrueshëm me energji elektrike duke rritur kështu edhe sigurinë e furnizimit.

Sektori që pritet të ketë rritje më të ndjeshme të kërkesave për energji pritet të jetë sektori i industrisë. Kjo bazohet në projeksionet e rritjes së GDP-së në njërin anë dhe në krahasimin me strukturën e konsumit të vendeve në zhvillim.

Me gjithë parashikimet e rritjes së ritmit të zhvillimit të industrisë, pjesëmarrja e industrisë në konsumin e përgjithshëm të energjisë në vitin 2024 pritet të jetë rreth 28% të energjisë finale të konsumuar.

Pasqyra e konsumit të energjisë në të gjithë sektorët është paraqitur në Tabelën 8.

Tabela 8. Pasqyra e parashikimit të konsumit të energjisë në të gjithë sektorët

	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Sektori i industrisë	370.57	378.87	389.85	401.18	412.86	424.90	437.32	450.12	464.78	479.96
Sektori i amvisërisë	533.03	528.83	536.31	546.93	555.40	565.40	576.72	587.74	601.59	616.46
Sektori i shërbimeve	130.83	131.51	134.91	138.38	141.96	145.62	149.39	153.26	158.08	163.17
Sektori i bujqësisë	31.19	32.42	33.75	35.14	36.59	38.11	39.68	41.32	43.05	44.86
Sektori i transportit	340.44	348.23	356.26	364.56	373.13	381.97	391.10	400.53	410.25	420.29
Totali	1406.06	1419.84	1451.09	1486.20	1519.94	1556.01	1594.21	1632.97	1677.76	1724.73

Në Tabelën 9. paraqitet kontributi i secilit sektor në konsumin e përgjithshëm, për vitet karakteristike: 2015- viti i parë i periudhës së parashikimit 2015-2024 dhe 2024 viti i fundit i periudhës së parashikimit .

Tabela 9. Pasqyra e konsumit të parashikuar për të gjithë sektorët ekonomik (në ktoe dhe %)

Sektoret	2015		2024	
	ktoe	%	ktoe	%
Industri	370.57	26.4	479.96	27.8
Amvisëri	533.03	37.9	616.46	35.7
Shërbime	130.83	9.3	163.17	9.5
Bujqësi	31.19	2.2	44.86	2.6
Transport	340.44	24.2	420.29	24.4
Gjithësej	1406.06	100.0	1724.73	100.0

8. Parashikimi i kërkesës për burime të ndryshme të energjisë

Deri në vitin 2013, produkti energjetik më i kërkuar ka qenë nafta dhe produktet e saj. Një gjë e tillë pritet që ta përcjellë kërkesën për energji edhe në periudhën afatgjatë 2015-2024.

Tabela 10. Pasqyra e konsumit të parashikuar për të gjitha produktet energjetike (në ktoe)

	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Thëngjill për qëll. energjetike	60.59	61.20	61.81	62.43	63.05	63.68	64.32	64.96	65.61	66.27
Thëngjill qëll. jo-energjetike	0.48	0.48	0.49	0.49	0.50	0.50	0.51	0.51	0.52	0.52
Produkte naftë për qëll. energjetike	578.85	594.23	610.12	626.53	643.48	660.99	679.07	697.74	717.02	736.93
Produkte naftë për qëll. jo-energjetike	49.77	51.41	53.10	54.86	56.67	58.54	60.47	62.46	64.53	66.66
Biomasë	255.73	258.52	261.34	264.20	267.08	270.00	272.94	275.92	278.93	281.98
Energji elektrike	450.74	443.27	452.84	465.66	476.52	488.97	502.83	516.52	535.48	555.72
Ngrohje e përfituar	9.21	9.70	10.19	10.65	11.01	11.53	12.11	12.70	13.35	13.99
Energji solare	0.71	1.03	1.20	1.38	1.63	1.81	1.98	2.15	2.32	2.67
Totali	1406.06	1419.84	1451.09	1486.20	1519.94	1556.01	1594.21	1632.97	1677.76	1724.73

Në tabelën 11. janë paraqitur të dhënat e produkteve energjetike për dy vitet e skajshme të periudhës afatgjatë të parashikimit të kërkesave për energji.

Tabela 11. Pasqyra e konsumit të parashikuar për të gjitha produktet energjetike (në ktoe dhe %)

Produktet energjetike	2015		2024	
	ktoe	%	ktoe	%
Thëngjilli	61.07	4.3	66.79	3.9
Produktet e naftës	628.61	44.7	803.59	46.6
Biomasë	255.73	18.2	281.98	16.3
Energji elektrike	450.74	32.1	555.72	32.2
Ngrohje e përfituar	9.21	0.7	13.99	0.8
Energji solare	0.71	0.1	2.67	0.2
Gjithësej	1406.06	100.0	1724.73	100.0

9. Parashikimi i konsumit të energjisë elektrike per periudhen 2015-2024

Në tabelen në vijim paraqitet parashikimi i kërkesës për energji elektrike për periudhen 2015-2024

SKENARI BAZË I KERKESES SE ENERGISË (GWh)	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Konsumatorët shtëpiak (rezidencial)	2536	2643	2705	2763	2786	2636	2814	2726	2768	2842	2892	2958	3039	3116	3223	3340
Konsumatorët komercial	701	745	798	872	847	855	898	887	913	939	965	996	1028	1057	1097	1137
Konsumatorët e industrial total	1210	1296	1322	1201	1124	1309	1342	1358	1398	1437	1478	1525	1574	1619	1679	1741
Humbjet në KOSTT	175	131	115	128	110	115	116	116	117	118	121	122	123	124	126	128
Humbjet teknike në OSSH	799	780	785	778	767	659	685	747	739	732	725	717	710	703	696	689
Bruto Konsumi i Kosovës	5421	5594	5725	5742	5634	5574	5854	5833	5936	6068	6180	6318	6473	6620	6820	

Burimi i të dhënave: "Balanca Afatgjatë e Energjisë Elektrike 2015-2024" -KOSTT

Spektori shtëpiak në vitin 2013 ka konsumuar 2786 GWh apo 49% të bruto konsumit të energjisë elektrike, kurse në vitin 2024 parashihet të konsumohet 3340 GWh apo pjesëmarrja parashihet të jetë 47%. Spektori komercial në vitin 2013 ka konsumuar 847 GWh apo 15% të bruto konsumit të energjisë elektrike, kurse në vitin 2024 ky sektor parashihet të konsumoj 1137 GWh apo 16% të totalit të konsumit të energjisë elektrike. Spektori i industrisë ka konsumuar 1124 GWh energji elektrike në vitin 2013 apo 20% të bruto konsumit, kurse në vitin 2024 ky sektor parashihet të konsumoj 1741 GWh apo 25% të bruto konsumit të energjisë elektrike.

Humbjet e realizuara të KOSTT-it në vitin 2013 ka qenë 110 GWh apo 2% të bruto konsumit të energjisë elektrike, kurse për vitin 2024 parashihet që të ketë humbje 128 GWh apo 2% të bruto konsumit të energjisë elektrike.


Humbjet teknike të OSSH-së në vitin 2013 kanë qenë 767 GWh apo 14% të bruto konsumit të energjisë elektrike, kurse në vitin 2024 parashihet të jenë humbjet teknike 689 GWh apo 10% të bruto konsumit të energjisë elektrike.

10. Parashikimi i prodhimit të energjisë elektrike për periudhën 2015-2024

PRODHIMI BRUTO I ENERGJISE SKENARI BAZE (MZHE) [GWh]		2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
1	TC KOSOVA A	1622	1908	2203	2108	2186	1624	2143	2142	2142	2142	2142	0	0	0	0	0
2	TC KOSOVA B	3638	3573	3494	3739	4196	3894	4202	4195	3260	3348	4392	4392	4392	4392	4392	4392
3	TC KOSOVA E RE	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3135	4703	4703	4703	4495
4	TC E REJA	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
5	TOTALI NGA TERMOCENTRALET (1+2+3+4)	5260	5481	5696	5847	6382	5518	6345	6337	5402	5490	6534	7527	9095	9095	9095	8887
6	HC UJMANI	89	115	75	66	101	82	84	82	82	82	84	84	84	80	82	80
7	HC LUMBARDHI	33	36	22	23	30	26	60	92	92	105	105	105	105	105	105	105
8	HC DIKANCE+BURIMI+RADAVCI	0	14	14	23	22	18	18	23	22	26	26	26	26	26	26	26
9	HC ZHURI	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	398	398	398	398	398
10	HC E VOGLA	0	0	0	0	0	0	0	609	654	731	821	1001	1001	1001	1001	1001
11	TOTAL NGA HIDROCENTRALET (6+7+8+9)	121	166	112	112	152	125	162	806	850	944	1036	1614	1614	1610	1612	1610
12	CENTRALET NGA BIOMASA (Mbetjet natyrore)	0	0	0	0	0	0	0	45	60	75	90	105	105	105	105	105
13	CENTRALET NGA ERA	0	3	0	0	0	3	3	181	222	262	282	302	302	320	320	332
14	CENTRALET SOLARE	0	0	0	0	0	0	8	12	14	16	19	21	23	25	27	31
15	Totali biomasa,era,solar (12+13+14)	0	3	0	0	0	3	11	239	296	353	391	428	430	450	452	468
16	TOTALI RIPËRTËRISHME (11+15)	121	169	112	112	152	128	173	1045	1146	1297	1426	2041	2043	2060	2064	2078
17																	
18	TOTALI BRUTO PRODHIMI (5+11+15)	5381	5650	5808	5959	6534	5646	6518	7382	6548	6787	7960	9568	11138	11155	11159	10965
19	TOTALI SHPENZIMET VETANAKE TE CENTRALEVE	579	603	605	594	632	586	586	671	583	593	694	756	913	913	913	892
20	TOTALI NETO PRODHIMI (18-19)	4802	5047	5203	5365	5902	5059	5932	6711	5965	6194	7266	8812	10226	10242	10246	10073

Burimi i të dhënave: "Balanca Afatgjatë e Energjisë Elektrike 2015-2024"-KOSTT

11. Rarashikimi i importit të Energjisë Elektrike 2015-2024



12. Emetimi i ndotësve të ajrit nga prodhimi i energjisë elektrike në Kosovë

Sektori energjetik është një ndër ndotësit më të mëdhenj të mjedisit në Kosovë, posaçërisht në rajonin e Prishtinës përfshirë komunat përreth ku janë të koncentruar të gjitha burimet termo-gjeneratorike ekzistuese. Emissionet e gazrave nga termocentralet me përqendrim të madh të NO_x, SO₂ dhe pluhurit, shkaktojnë ndotjen e madhe të ajrit. Është e evidente që sektori energjetik në Kosovë është po ashtu kontribuesi më i madh në shkarkimin e gazrave të serës (CO₂)

12.1 Gjendja aktuale e nivelit të emetimit të ndotësve nga termocentralet dhe parashikimi i emetimit 2015-2024

Në tabelën 8-1 janë paraqitur vlerat e përafërta të koncentrimin të ndotësve: NO_x, SO₂, dhe pluhurit, për dy termocentralet ekzistuese duke u krahasuar me vlerat standarde sipas Direktivës 2001/80/EC, të shkoqitura nga studimi për vlerësimin mjedisor të ndikimit të kapaciteteve të reja gjeneruese "SESA"

Tabela. 8-1 Krahasimi i koncentrimin të emetimit të ndotësve në njësitë ekzistuese të termocentraleve

TC Kosova A dhe TC Kosova B në raport me nivelet standarde të lejuara.

Njesia e TC-ve	P1 1huri		Nox		SO2	
	mg/m ³	mg/m ³	mg/m ³	mg/m ³	mg/m ³	mg/m ³
	Aktual	Standardi	Aktual	Standardi	Aktual	Standar
KOSOVA A3	100-200	100	700	600	300	<1200
KOSOVA A4	100-200	100	700	600	300	<1200
KOSOVA A5	100-200	100	700	600	300	<1200
KOSOVA B1	150	100	700	600	400	400
KOSOVA B2	150	100	700	600	400	400

* Gjendja e emetimit të pluhurit pas zëvendësimit të filtrave 2012-2013 në A3, A4 dhe A5
Burimi i të dhënave: "Balanca Afatgjatë e Energjisë Elektrike 2014-2024" - KOSTT

Termocentrali "Kosova e Re" do të ndërtohet sipas teknologjisë më të fundit sa i përket zbatimit të kërkesave mjedisore dhe niveli i ndotjes do të jetë nën nivelin e lejuar nga standardet Evropiane për termocentralet e reja nga linjiti.

Në tabelën 8-2 mund të shihen faktorët e emetimit për termocentralin "Kosova e Re"

PARAMETRAT	NOX t/GWh	SO2 t/GWh	CO2 t/GWh	Pluhur t/GWh	Lignjit t/MWh
TC KOSOVA E RE	0.548	0.730	1097.000	0.037	1.135
Perqindja ndaj 1t lignit	0.048%	0.064%	96.652%	0.003%	

Në figurën 8-2. është paraqitur parashikimi i emetimit të ndotësve (NO_x, SO₂ dhe pluhurit) për periudhën kohore 2015-2024 dhe emetimi në tri vitet paraprake shkaktuar nga prodhimi i energjisë elektrike nga termocentralet sipas skenarit bazë të zhvillimit të gjenerimit, ndërsa në figurën 8-3 është paraqitur parashikimi i emetimit të CO₂ për të njëjtin skenar.




Figura 8-2. Parashikimi i emetimit të pluhurit, NO_x dhe SO₂ nga termocentralet e Kosovës për periudhën kohore 2015-2024




Figura 8-3. Parashikimi i emetimit të CO2 nga termocentralet për periudhën kohore 2015-2024